

RREGULLAT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË “ ACIBADEM CLINICS”

Përkufizimet zyrtare

Banka – person juridik i cili, në bazë të licencës përkatëse bankare , ka të drejtën ekskluzive të ofrojë shërbime bankare në territorin përkatës të: Azerbajxhanit, Kazakistanit, Uzbekistanit, Kirgistanit, Taxhikistanit, Turkmenistanit, Bjellorusisë, Moldavisë, Ukrainës, Gjeorgjisë, Serbisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Maqedonisë Veriore, Malit të Zi, Kosovës dhe Shqipërisë.

Partneri teknik – “INFOCUS” SHPK, me kod identifikimi të personit juridik: 36563986, me lokacion në Sheshin Sportnyvna 1A, Kyiv, 01023, Ukrainë.

Mbajtësi i kartës – do person fizik që është mbajtës i kartës dhe është regjistruar në Chatbot, që ka të drejtë të pranojë Shërbimet në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave.

Karta – kartë pagese Visa , e lëshuar nga Banka.

Konsumatori – Visa International Service Association, me lokacion në Metro Center Boulevard 900, Foster City, CA 94404 – 2775, SHBA.

Messenger – aplikacioni mobil për dërgim të shpejtë të mesazheve dhe video-komunikim, përfshirë Telegramin.

Kontraktori – ACIBADEM HEALTHCARE GROUP, me kod identifikimi të personit juridik : 3890729631, lokacioni: GC Yeme İçme Hizmetleri A.Ş.

Shërbimi – shërbim kontrolli mjekësor i ofruar nga Kontraktori, në përputhje me përshkrimet e publikuara në webfaqen: <https://acibademinternational.com/>.

Privilegji – një zbritje prej 15%, e cila ofrohet sipas kushteve të këtyre Rregullave gjatë pagesës së këtyre shpenzimeve, përfshirë konsultat mjekësore, testet laboratorike, testet radiologjike, operacionet dhe kontrollet shëndetësore, në spitalet e Kontraktorit në Turqi, duke e përdorur Kartën. Pagesa bëhet vetëm te kesh sportelet e Kontraktorit duke e përdorur Kartën (pagesa duke përdorur Kartën konsiderohet si pagesë me kartë plastike,, duke e përdorur teknologjinë NFC).

Rregullat – këto rregulla për ofrimin e shërbimeve në “Acibadem Clinics”.

Kushtet e vlefshmërisë – periudha nga 10.08.2024 deri më 31.05.2026, nëse nuk specifikohet ndryshe nga Konsumatori.

Chatbot – Chatbot-i që gjendet te linku vijues: <https://t.me/VisaConciergeBot>

Të gjitha kushtet që nuk përkufizohen në këto Rregulla përkufizohen nga dispozitat e legjislacionit në fuqi në Ukrainë.

1. Si të përfitohet Privilegji

- 1.1.** Për të përfituar nga Privilegji, Mbajtësi i kartësduhet të bëjë si vijon:
 - 1.1.1.** të jetë Mbajtës i vleshëm i kartës;
 - 1.1.2.** ta regjistrojë veten ose të jetë i/e regjistruar në Chatbot, sipas procedurës së brendshme të regjistrimit të përcaktuar aty;
 - 1.1.3.** të zgjedhë menynë “Health and Care” (Shëndeti dhe përkujdesja);
 - 1.1.4.** të njihet me këto Rregulla;
 - 1.1.5.** t’i pranojë këto Rregulla;
 - 1.1.6.** ta zgjedhë njërin nga opsionet vijuese:
 - 1.1.6.1.** 15% zbritje në Kontrolle. Duke e zgjedhur këtë opsion, Mbajtësi i kartës mund ta pranojë Shërbimin. Mbajtësi i kartës mund ta autorizojë Partnerin Teknik t’ia caktojë një termin për Shërbimin përkatës, duke e specifikuar emrin, mbiemrin, datën, kohën, klinikën dhe numrin e telefonit për terminin.
- 1.2.** Këto Rregulla do të jenë dokumenti kryesor në marrëdhëniet zyrtare midis Mbajtësi i kartës dhe Partnerit Teknik/Konsumatorit/ Kontraktorit. Kontraktormund të ketë rregulla/kushte të veta shtesë për ofrimin e Shërbimeve, që, megjithatë, nuk duhet të ndryshojnë nga këto Rregulla. Mbajtësi i kartës i pranon me vullnet të lirë këto rregulla/kushte dhe mban përsipër pasojat e këtij pranimi.
- 1.3.** Pranimi nga Mbajtësi i kartës bëhet në mënyrë vullnetare dhe nënkupton lidhjen e një marrëveshjeje me shkrim në kushtet e këtyre rregullave..

2. Si të pranohen Shërbimet, kufizimet e Shërbimit dhe Privilegjeve

- 2.1.** Privilegji dhe Shërbimi nuk mund të kombinohen me zbritjet apo oferta të tjera promovuese. Privilegji dhe Shërbimi nuk vlejnë për shpenzimet që i mbulon sigurimi. Privilegji dhe Shërbimi nuk zbatohen në promocione apo marrëveshje korporative. Privilegji dhe Shërbimi nuk mund të zbatohen pas pagesës.
- 2.2.** Kontraktori e rezervon të drejtën ta anulojë cilindo Privilegj apo Shërbim me pajtimin e Konsumatorit pa ndonjë njoftim paraprak, në rast të keqpërdorimit apo mashtrimit.
- 2.3.** Nuk ofrohen kompensime monetare për çfarëdo Privilegji apo Shërbimi që nuk është ofruar apo pranuar.

3. Përgjegjësia e Palëve

- 3.1.** Të gjitha ankesat duhet të dorëzohen nga Mbajtësi i kartës drejtpërdrejt te Kontraktori. Mbajtësi i kartës nuk mund të dorëzojë ankesa te Konsumatori, Banka apo Partneri Teknik.
- 3.2.** Pa paragjykim të të lartpërmendurave dhe jo me qëllim të mospërputhjes me dispozitat ligjore, Konsumatori dhe/apo Partneri Teknik dhe/apo Banka nuk

mbajnë përgjegjësi për çfarëdo dëmi të shkaktuar ndonjë prone apo personi, ose nëse Shërbimet apo Privilegjet nuk i përmbushin pritjet e Mbajtësi të kartës apo të palëve të treta.

- 3.3.** Partneri Teknik dhe/apo Konsumatori dhe/apo Banka nuk mbajnë përgjegjësi për subjektin, cilësinë, sasinë dhe kohën e ofrimit të Shërbimeve dhe Privilegjeve nga Kontraktori si rezultat i pamundësisë së përdorimit të Shërbimit (duke përfshirë edhe mungesën e kohës së lirë për regjistrim).

4. Të ndryshme

- 4.1.** Partneri Teknik ka të drejtë të përfshijë palë të treta për të përmbushur obligimet të përcaktuara në këto Rregulla.
- 4.2.** Në rast të interpretimit të paqartë të këtyre Rregullave, çfarëdo kontest dhe/apo çështje që nuk rregullohet nga këto rregulla, Konsumatori katë drejtë t'i zgjidhë ato çështje në mënyrë të pavarur. Ky vendimi i tij është përfundimtar dhe nuk i nënshtrohet ankesave..
- 4.3.** Partneri Teknik/Konsumatori e rezervon të drejtën t'i ndryshojë Rregullat. Në këtë rast, njoftimi do të bëhet duke postuar në Chatbot. Këto ndryshime hyjnë në fuqi që nga momenti i publikimit, përveç nëse përcaktohet ndryshe.
- 4.4.** Pagesa e taksave, tarifave dhe pagesave të detyrueshme duhet të bëhet nga personi të cilit i ngarkohet detyrimi përkatës nga dispozitat e legjislacionit në fuqi..
- 4.5.** Kur porositen Shërbimet apo Privilegjet, Mbajtësit e kartës këshillohen që t'i lexojnë me kujdes rregullat për marrjen e Shërbimit apo Privilegjit dhe t'i kenë parasysh të gjitha kushtet (përzgjedhjen e laboratorit/klinikës, kushtet e zbatimit sipas rregulloreve të brendshme të institucionit mjekësor, rekomandimet për përgatitje për manipulim, etj.). Shërbimet mjekësore ofrohen ekskluzivisht në përputhje me rregullat/rregulloret e brendshme të institucionit mjekësor, ku Konsumatori, Partneri Teknik dhe Banka nuk kanë kurrfarë ndikimi ligjor.

5. Të dhënat personale

- 5.1.** Të dhënat personale, si dhe çështjet e kërkesave, që u transferohen Partnerit Teknik, përbëjnë informacion me qasje të kufizuar, përfshirë të dhënat mbi shëndetin, që rregullohet nga garancitë e siguruara nga dispozitat e legjislacionit në fuqi të Ukrainës, në veçanti nga: Ligji i Ukrainës “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Kodi Civil i Ukrainës, si dhe aktet e tjera ligjore juridike.
- 5.2.** Me pranimin e këtyre Rregullave, Mbajtësi i kartës jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij/saj personale nga Partneri Teknik, si dhe të dhënave shëndetësore, pa rezervime apo kufizime, dhe e konfirmon, që me dhënien e këtij pëlqimi, ai/ajo vepron lirshëm, me vullnet të lirë dhe në interes të vet. Pëlqimi për

përpunimin e të dhënave personale jepet me qëllim të pranimit të Shërbimeve dhe Privilegjeve.

- 5.3.** Lista e të dhënave personale: mbiemri, emri, numri i telefonit, si dhe e të dhënave të tjerat të pranuar, përfshirë të dhënat shëndetësore të specifikuara në këto Rregulla (nëse është e nevojshme).
- 5.4.** Mbajtësi i kartës e jep pëlqimin rreth veprimeve vijuese me të gjitha të dhënat e specifikuara personale: mbledhja, sistematizimi, akumulimi, ruajtja, transferimi, qartësimi (azhurnimi apo modifikimi), përdorimi, zhdukja, si dhe çfarëdo veprimi tjetër me të dhënat personale në pajtim me ligjin në fuqi. Përpunimi i të dhënave mund të kryhet edhe përmes mjeteve automatike dhe pa to (në rast të përpunimit jo-automatik). Kur përpunohen të dhënat personale, Partneri Teknik nuk është i kufizuar në përdorimin e metodave të përpunimit.
- 5.5.** Mbajtësi i kartës me anë të kësaj pranon dhe konfirmon se, nëse është e nevojshme,, Partneri Teknik ka të drejtë t'i shpërndajë të dhënat personale te palët e treta, vetëm për qëllim të ofrimit të Shërbimeve dhe Privilegjit (në veçanti, te Kontraktorit, si dhe te palët e treta të huaja që u ofrojnë shërbime të ruajtjes së të dhënave Partnerit Teknik). Këto palë të treta kanë të drejtë t'i përpunojnë të dhënat personale si rezultat i dhënies së këtij pëlqimi.
- 5.6.** Ky pëlqim është i vlefshëm deri në revokimin e tij duke dërguar një mesazh te Partneri Teknik në Chatbot. Në rast të marrjes së një deklarate me shkrim mbi revokimin, Partneri Teknik është i detyruar të ndalojë përpunimin dhe të përjashtojë të dhënat personale nga baza e të dhënave, përfshirë atë elektronike..
- 5.7.** Në rast të mosmarrëveshjes me kushtet e Rregullave, Mbajtësi i kartës nuk përfiton nga Shërbimi dhe Privilegji.
- 5.8.** Këto rregulla mbi përpunimin e të dhënave personale janë pjesë e politikës së përpunimit të të dhënave personale të përfshira në Chatbot..
- 5.9.** Partneri Teknik nuk e verifikon vërtetësinë e të dhënave personale të ofruara, duke supozuar që Mbajtësit e Kartës veprojnë në mirëbesim dhe i mbajnë të dhënat e tyre personale të azhurnuara dhe nuk është përgjegjës për dhënien vullnetare të informacionit të tyre të kontaktit.
- 5.10.** Përpunimi i të dhënave personale kryhet pa kufizime kohore, me çdo mjet ligjor, përfshirë këtu përpunimin në sisteme të informacionit të të dhënave personale duke përdorur mjete të automatizimit apo pa përdorimin e këtyre mjeteve – deri në datën e arritjes së qëllimit të përpunimit të të dhënave personale.